


Raport i Monitorimit 

# I ZBATIMIT TË PAKOS SË RINGJALLJES EKONOMIKE TË QEVERISË



**Autori:** Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP)

**Programi:** Qeverisja Demokratike

**Publikuar:** Dhjetor 2021

Të gjeturat, qëndrimet dhe rekomandimet e këtij raporti nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet e Balkan Trust for Democracy, Fondit Gjerman Marshall të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, USAID-it apo të Qeverisë Amerikane.

# Përmbajtja

Hyrje	5
Metodologjia	7
Konsultimet para miratimit të Pakos së Ringjalljes Ekonomike	8
Miratimi i pakos	9
Raporti i Zbatimit	11
Masa 1 - Mbështetja e Punësimit	11
<b>Niveli i Zbatimit</b>	<b>14</b>
Masa 2 - Ringjallja e Ekonomisë dhe Prodhimit	17
<b>Niveli i Zbatimit</b>	<b>18</b>
Masa 3 - Mbështetja për familjen	19
<b>Niveli i Zbatimit</b>	<b>20</b>
Masa 4 - Mbështetja për publiken	22
<b>Niveli i Zbatimit</b>	<b>23</b>
Masa 5 - Investimi në infrastrukturë dhe ambient	25
Përfundime	26



# Hyrje

Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP), në kuadër të projektit “Rimëkëmbje për Qëndrueshmëri”, projekt i cili mbështetet Balkan Trust for Democracy (BTD) dhe USAID-i, ka analizuar dhe monitoruar procesin e implementimit të Pakos së Ringjalljes Ekonomike. Raporti i monitorimit është fokusuar në të dhënat e marra nga Ministria e Financave dhe institucionet tjera përgjegjëse në këtë proces, si Administrata Tatimore e Kosovës etj. Ky raport tenton të pasqyrojë të arriturat e deri më tashme të Pakos së Ringjalljes Ekonomike.

Pandemia COVID-19 ka shkaktuar dëme në thuajse secilën sferë të jetës. Vështirësitë e qytetarëve ndaj një vështirësie të tillë, pa ndihmën e akterëve më të lartë shtetëror, do përshkallzoheshin duke rrezikuar seriozisht mirëqenien sociale dhe atë ekonomike. Pasojat e pandemisë u tentua të zbuten përmes pakove të cilat përmbanin masa ndihmuese për kategoritë më të prekura nga kjo sfidë. Në Republikën e Kosovës, gjatë periudhës pandemike u miratuan disa pako të ndihmave. Këtyre pakove ju parapriu Pako

Emergjente Fiskale në muajin mars të vitit 2020, e pastaj Pako e Rimëkëmbjes Ekonomike në muajin dhjetor të vitit 2020 dhe së fundmi Pako e Ringjalljes Ekonomike që erdhi në muajin korrik të këtij viti. Përfundimisht, që nga fillimi i pandemisë COVID-19 në Republikën e Kosovës, e deri më sot janë ndarë gjithsej 820.65 milionë Euro. Pako e fundit është më e madhja për nga shuma dhe më voluminozja, prandaj edhe monitorimi i saj paraqet rëndësi më të madhe.

Raporti i monitorimit është realizuar në kuadër të procesit të monitorimit të Pakos së Ringjalljes Ekonomike. Raporti vjen pas publikimit të katër buletinëve, infografikave paraprake dhe dy podcastëve, të cilat kanë për qëllim informimin e qytetarëve rreth masave dhe zbatimit të kësaj pako. Këto aktivitete të Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP) tentojnë që të rrisin transparencën dhe llogaridhënien, e në të njejtën kohë të mbajnë të informuar qytetarët rreth masave dhe përfitimeve që kanë ata ndaj Pakos së Ringjalljes Ekonomike.



# Metodologjia

Për hartimin e këtij raporti të monitorimit është përdorur metodologji e përzier, kuantitative dhe kualitative. Në pjesën ku është përdorur hulumtimi kuantitativ, INDEP përmes metodës së monitorimit dhe hulumtimit në tavolinë ka mbledhur të dhëna dhe informata rreth hapave të zbatimit të Pakos së Ringjalljes Ekonomike. Krahas kësaj në mënyrë që ky raport të jetë sa më i plotë, INDEP ka plotësuar gamën e informatave kuantitative edhe përmes hulumtimit kualitativ. Për përgaditjen e raportit të monitorimit INDEP ka organizuar takime dhe diskutime gjysmë të strukturuar me përfaqësues të Administratës Tatimore të Kosovës dhe Odës së Hotelerisë dhe Turizmit të Kosovës. INDEP gjithashtu ka përdorur metodën e vëzhgimit për të vlerësuar procesin e zbatimit, për të parë nga afër atë dhe për të vështruar sjelljen e akterëve zbatues përgjatë një kohështrirje prej katër muajve.

Pas mbledhjes së të dhënave, analiza e të dhënave ka kaluar në dy faza kryesore. Në fazën e parë, në kemi sistemuar të dhënat dhe i kemi bërë një analizë të përmbajtjes. Në pjesën e dytë ne kemi tabuluar të dhënat nga hulumtimi kuantitativ me përfundimet e nxjerra nga intervistat për të nxjerrë qëndrimet përfundimtare. Në fund, hulumtimi ka kaluar edhe nëpër një analizë të përgjithshme të kontekstit zhvillimor të Kosovës ku edhe kemi shkallëzuar nivelin e zbatimit të masave të Pakos së Ringjalljes Ekonomike.

Shkallëzimi i nivelit të zbatimit të masave është ndarë në katër nivele. Këto nivele janë:

## **1. Pa zbatim**

Masa nuk ka filluar funksionalizimin dhe INDEP nuk ka gjetur të dhëna që masa ka filluar të implementohet

## **2. Zbatim i kufizuar**

Masa është funksionalizuar por INDEP nuk ka gjetur të dhëna që masa ka filluar të implementohet

## **3. Zbatim i pjesshëm**

Masa është funksionalizuar dhe INDEP ka gjetur të dhëna që masa është duke u implementuar

## **4. Zbatim i plotë**

Masa është funksionalizuar dhe INDEP ka gjetur të dhëna që masa është implementuar plotësisht

Përmes këtij shkallëzimi do të paraqesim nivelin e zbatimit aktual të masave që përmban kjo pako e ndihmave ekonomike.

Të dhënat e këtij raporti janë marrë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Administrata Tatimore e Kosovës dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës. Këto të dhëna ndihmojnë në krahasimin dhe përcaktimin e nivelit të zbatimit të masave të Pakos së Ringjalljes Ekonomike. Përmes këtyre të dhënave, INDEP ka synuar saktësimin e informacioneve për qytetarët dhe akterët e tjerë relevant.

## Konsultimet para miratimit të Pakos së Ringjalljes Ekonomike



Qeveria e Kosovës tashmë ka miratuar dhe ka filluar aplikimin e Pakos së Ringjalljes Ekonomike.<sup>1</sup> Kjo pako ka për synim lehtësimin e dëmeve të shfaqura si rrjedhojë e pandemisë COVID-19. Kjo pako nuk është pako e parë e ndihmave që iu është ofruar qytetarëve, por është pako e katërt me rradhë. Kjo pako ka të alokuar 420 milionë euro dhe përfshin kategori mjaft të dëmtuara. Implementimi i pakos filloi pas ndryshimeve të bëra në ndarjet buxhetore dhe miratimit të pakos nga ana e Qeverisë së Kosovës.

Paraprakisht, Qeveria e Kosovës, saktësisht Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, ka pasur konsultime me akterët relevant në kuadër të formulimit të ndihmave, të cilat i përmban Pako e Ringjalljes Ekonomike. Një nga akterët kryesorë me të cilët ka pasur konsultime Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve është edhe Administrata Tatimore e Kosovës. Bashkëpunime dhe konsultime me ATK-në ka pasur edhe paraprakisht në pakot tjera, e ky bashkëpunim ka vazhduar edhe në Pakon e Ringjalljes Ekonomike, ku ATK ka qenë përgjegjëse për tre masa të kësaj pako.

<sup>1</sup> Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Lajme, Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve prezantoi Pakon e Ringjalljes Ekonomike prej 420 milionë Euro, e qasshme në <https://mf.rks-gov.net/Page.aspx?id=1,2,1091>, (qasur në nëntor, 2021)



Qeveria e Kosovës nuk ka mbajtur Konsultime Publike sa i përket Pakos së Ringjalljes Ekonomike. Një pako e tillë do të duhej të ndëgjonte nga afër kërkesat e qytetarëve. Për më tepër konsultimet publike janë të rregulluara edhe me Rregulloren Nr. 05/2016 për standardet minimale për procesin e konsultimit publik.<sup>2</sup> Kjo Rregullore ka për qëllim nxitjen dhe sigurimin e një procesi të konsultimit publik ndërmjet organeve publike, palëve të interesuara dhe publikut për një pjesëmarrje gjithëpërfshirëse në procesin e politikëbërjes dhe vendimmarrjes me interes publik si dhe rritjen e transparencës dhe përgjegjësisë së organeve publike ndaj palëve të interesuara dhe publikut.

**Ndonëse ka pasur konsultime me institucionet e tjera të nivelit qendror, Qeveria nuk ka organizuar konsultim publik për pakon e ringjalljes!**

## Miratimi i pakos



Qeveria e Republikës së Kosovës, duke parë dëmet e shkaktuara nga pandemia dhe pas rishikimit të buxhetit, publikoi Pakon e Ringjalljes Ekonomike. Dëmet nga pandemia COVID-19 janë të vërejtura tashmë ku sektorët si punësimi, ekonomia, bujqësia dhe shumë sektorë të tjerë janë prekur dhe për pasojë kanë regjistruar probleme të konsiderueshme. Këto dëme janë si pasojë e mbylljeve totale dhe mbylljeve të pjesshme, të cilat u konsideruan të domosdoshme për arsye të parandalimit të përhapjes së mëtutjeshme të pandemisë. Pako e Ringjalljes Ekonomike vjen si e katërta me rradhë me përmbajtje dhe fokus në tejkalimin e dëmeve të paraqitura si pasojë e COVID-19.

Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, në Mbledhjen e 17-të të Qeverisë, me datë 25 qershor 2021, ka paraqitur Rishikimin e Buxhetit për vitin 2021, që kap vlerën prej 2 miliardë e 516 milionë euro.<sup>3</sup> Rishikimi i Buxhetit erdhi si rrjedhojë e situatës së shkaktuar nga pandemia COVID-19. Ndër të tjera, mjetet e alokuara do të kontribuonin në luftimin e pandemisë dhe lehtësimin e rimëkëmbjes së qytetarëve dhe bizneseve.

<sup>2</sup> Qeveria e Kosovës, RREGULLORE (QRK) NR. 05/2016 PËR STANDARDET MINIMALE PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK, e qasshme në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15036>, (qasur në nëntor, 2021)

<sup>3</sup> Zyra e Kryeministrit, Mbledhja e 17-të e Qeverisë së Republikës së Kosovës, e qasshme në <https://kryeministri.rks-gov.net/mbledhja-e-17-te-e-qeverise-se-republikes-se-kosoves/>, (qasur në nëntor, 2021)

Rishikimi i Buxhetit kishte synim edhe alokimin apo ndarjen e mjeteve, përmes të cilave do të financohej Pako e Ringjalljes Ekonomike. Kjo pako, e cila përmban pesë masa kryesore, ka të parashikuara 420 milionë Euro, prej të cilave 190 milionë Euro janë të financuar përmes buxhetit të Republikës së Kosovës, ndërsa pjesa tjetër, pra 230 milionë Euro do të financohen përmes huamarrjes. Prezantimi i pakos u bë nga Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, në një konferencë për media me datën 30 qershor 2021.<sup>4</sup> Përfundimisht, pakoja u miratua në mbledhjen e 19-të të Qeverisë së Kosovës me datë 14 korrik 2021 dhe u konkretizua me ndryshimin dhe plotësimin e projektligjit nr. 08/L-016 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021.

Shqyrtimi i parë i projektligjit nr. 08/L-016 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, u vendos në rendin e ditës me datë 16 korrik 2021.<sup>5</sup> Përkatësisht kjo pikë ishte e teta e seancës së asaj date. Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere e kishte shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kishte rekomanduar miratimin e tij në parim. Shqyrtimi i parë i këtij projektligji u miratua me 69 vota për, ku më pastaj u dërgua edhe tek Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme, për shqyrtim të dokumenteve dhe rekomandime në lidhje me përmirësimin e tyre.

Me datë 28 korrik 2021 u mbajt seanca plenare e Kuvendit të Republikës së Kosovës, ku në rend të ditës ishte vetëm një pikë e cila lidhej me Shqyrtimin e dytë të Projektligjit nr. 08/L-016 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021.<sup>6</sup> Në këtë seancë u njoftuan apo u paraqitën edhe konstatimet e komisioneve të cilat lidheshin me këtë projektligj. Shqyrtimi i projektligjit nga komisionet përkatëse ndërlihdh mbarëvajtjen e procesit me efikasitetin e projektligjit. Andaj edhe konstatimet e komisioneve nuk ishin në një vijë të njejtë me njëra tjetrën.

Komisioni për Buxhet, Punë dhe Transfere pas shqyrtimit të projektligjit dhe amandamenteve të tij, konstatoi se ky projektligj duhet të miratohej. Kjo me arsyetimin se një buxhet i tillë do të mundësoj më shumë intervenime në zhvillimin ekonomik dhe lehtësimin e pasojave pandemike. Komisioni për Integritet Evropian vlerësoi se projektligji dhe amendamentet e propozuara nuk rregullohen në mënyrë specifike nga legjislacioni i Bashkimit Evropian.

<sup>4</sup> Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Lajme, Ministri i Financave, Punës dhe Transfere prezantoi Pakon e Ringjalljes Ekonomike prej 420 milionë Euro, e qasshme në <https://mf.rks-gov.net/Page.aspx?id=1,2,1091>, (qasur në nëntor, 2021)


<sup>5</sup> Kuvendi i Kosovës, Seancat, TRANSKRIPT I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 16, 19, 21 E 28 KORRIK DHE 6 GUSHT 2021, e qasshme në [https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Session-Files/2021\\_07\\_16\\_ts\\_Seanca\\_LsKbMwLDMm.pdf](https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/Session-Files/2021_07_16_ts_Seanca_LsKbMwLDMm.pdf), (qasur në nëntor, 2021)

<sup>6</sup> Kuvendi i Kosovës, Seancat, TRANSKRIPT I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 28 KORRIK 2021, e qasshme në [https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2021\\_07\\_28\\_ts\\_Seanca\\_BPnafK-k9ME.pdf](https://www.kuvendikosoves.org/Uploads/Data/SessionFiles/2021_07_28_ts_Seanca_BPnafK-k9ME.pdf), (qasur në nëntor, 2021)

Ndërsa Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komunitetit dhe Kthimit e vlerësoi se projektligji dhe amendamentet e propozuara nuk i cenojnë dhe nuk i prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-016 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021 u miratua me 69 vota për. Miratimi në Kuvendin e Republikës së Kosovës së këtij projektligji, hapi rrugë për operacionalizimin e Pakos së Ringjalljes Ekonomike. Kjo pasi që pakoja në fjalë ishte e përfshirë në Rishikimin e Buxhetit.

### Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 08/L-016 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021



Me miratimin e buxhetit të rishikuar, iu hap rrugë funksionalizimit të Pakos së Ringjalljes Ekonomike. Pakoja dhe masat e përfshira në të, filluan operacionalizimin gradual dhe jo të gjitha përnjëherë. Andaj, edhe prezantimi i tyre për publikun u bë gradualisht. Masat e para të cilat u prezantuan dhe filluan funksionimin ishin masat 1.2 Mbështetja për të Punësuarit e Formalizuar me datë 29 korrik 2021<sup>7</sup>, masa 1.3 Mbështetja e punësimit të grave me datë 5 gusht 2021<sup>8</sup> dhe masa 1.1 Rikthimi në punë i atyre që kanë humbur vendin e punës me datë 6 gusht 2021.<sup>9</sup> Të tre këto masa kanë qenë nën mbikqyrjen e Administratës Tatimore të Kosovës – ATK.

<sup>7</sup> Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Lajme, Ministri Murati prezanton masën 1.2 - Mbështetja për të Punësuarit e Formalizuar të 7 Pakos së Ringjalljes Ekonomike, e qasshme në <https://mf.rks-gov.net/Page.aspx?id=1,2,1105>, (qasur në nëntor, 2021)

<sup>8</sup> Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Lajme, Ministri Murati prezanton masën 1.3 të Pakos së Ringjalljes Ekonomike - Mbështetja e punësimit të grave, e qasshme në <https://mf.rks-gov.net/Page.aspx?id=1,2,1108>, (qasur në nëntor, 2021)

<sup>9</sup> Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Lajme, Ministri Murati prezanton masën 1.1 të Pakos së Ringjalljes Ekonomike - Rikthimi në punë i atyre që kanë humbur vendin e punës gjatë pandemisë, e qasshme në <https://mf.rks-gov.net/Page.aspx?id=1,2,1110>, (qasur në nëntor, 2021)

Pjesë përbërëse e pakos janë edhe Bonot e Diasporës. Bonot e diasporës janë letra me vlerë, të cilat mund të bliheshin nga të gjithë personat fizik, rezidentë dhe jo-rezidentë, që posedojnë llogari bankare në njërin nga bankat komerciale të listuar më poshtë. Bankat komerciale partnere përmes së cilave mund të investohej në Bono të Diasporës janë:

- Banka Ekonomike
- Banka Tregtare Kombëtare
- Banka për Biznes
- NLB Banka
- ProCredit Bank
- Raiffaisen Bank

## Raporti i Zbatimit

### Masa 1 Mbështetja e Punësimit

Mjetet e mbledhura nga Bonot e Diasporës parashihen të përdoren për të mbështetur prodhuesit vendorë në kuadër të Masës 2.1 të Pakos së Ringjalljes Ekonomike. Shuma totale e mbledhur nga këto letra me vlerë është 10.43 milionë Euro, dhe data e fundit për aplikim ishte 18 gusht 2021.

Masa e parë e quajtur Mbështetja e Punësimit është nga prioritetet kryesore, pasi që edhe fokusi i qytetarëve është tek punësimi. Pandemia COVID-19 solli vështirësi në mbarëvajtjen e proceseve dhe kështu shkaktoi rrezikim të vendeve të punës e madje edhe humbje të vendit të punës për shumë qytetarë. Përmes Pakos së Ringjalljes Ekonomike janë alokuar 50 milionë Euro, të shpërndara në shtatë nënmasa. Shtatë nënmasat e masës së parë të Pakos së Ringjalljes Ekonomike janë:

1. Rikthimi në punë i atyre që kanë humbur vendin e punës gjatë pandemisë
2. Mbështetja për të punësuarit e formalizuar


3. Mbështetja e punësimit të grave
4. Skema e punësimit të garantuar për të rinjtë
5. Trajnimi dhe punësimi në TI
6. Mbështetja e punësimit të personave me nevoja të veçanta
7. Skema e granteve për zanatet

Përmes këtyre nënamasave do të krijohen kushte për mbështetje për punëdhënësit dhe punëkërkuarët të cilët janë dëmtuar si pasojë e pandemisë.

Kjo pako dhe pakot paraprake ndikuan në formalizimin e ekonomisë joformale dhe të punësuarve që i përkasin këtij sektori. Kjo pasi që masat e pakove të ndihmave për lehtësimin e dëmeve të shkaktuara nga pandemia COVID-19 kërkonin formalizimin dhe deklarimin e të punësuarve në mënyrë që të përfitonin nga ndihmat. Edhe kjo pako, përmban masën e cila direkt lidhet me formalizimin e ekonomisë joformale. Një qasje e tillë kontribuon në evaluimin e saktë të personave të punësuar dhe krijon një ekonomi më stabile. Këto masa kanë treguar ndikim në shkallën e punësimit në Republikën e Kosovës.

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës<sup>10</sup>, 28.4% e popullsisë të cilët janë në moshë pune ishin të punësuar gjatë vitit 2020.<sup>11</sup> Në vitet paraprake, respektivisht 2018 dhe 2019, shkalla e punësimit ishte 28.8% dhe 30.1%. Niveli i përqindjes do të ishte ende më i lartë nëse nuk do të regjistroheshin si të punësuar shumë qytetarë, të cilët kanë punuar në ekonominë joformale, por për shkak të përfitimit nga masat e pakove të ndihmave nga Qeveria e Republikës së Kosovës, ata u regjistruan si të punësuar.

### Shkalla e papunësisë



<sup>10</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës, ASK, e qasshme në <https://ask.rks-gov.net/>

<sup>11</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës, ASK, Anketa e Fuqisë Punëtore 2020, e qasshme në <https://ask.rks-gov.net/media/6125/anketa-e-fuqis%C3%AB-pun%C3%ABtore-afp-2020.pdf>

Qëllimi i masës së parë të Pakos së Ringjalljes Ekonomike është ofrimi i ndihmës në sektorin e punësimit, në mënyrë që sado pak të lehtësohet dëmi i shkaktuar nga pandemia COVID-19. Andaj edhe nënmasat e saj ofrojnë ndihma dhe grante për sektorët më të prekur. Rikthimi në punë ka qenë veçanërisht i mundshëm për punëtorët që mbanin një lidhje me punëdhënësin e tyre të mëparshëm. Masat e detyrueshme të distancimit shoqëror si qëndrimi në shtëpi dhe urdhrat e mbylljes kanë pasur një efekt relativisht të vogël në rimëkëmbjen e punësimit, ndërsa shpërndarja e virusit ka pasur një efekt më të madh. Kjo tregon se rikthimi në punë dhe krijimi i vendeve të reja të punës do të jetë më i lehtë dhe më i arritshëm me rastin e përfundimit të pandemisë. Andaj edhe masat e ofruara përmes kësaj pako nuk do të mund të arrijnë nivelin e mbulimit të të gjithë dëmit që është shkaktuar në këtë sektor.

## Niveli i Zbatimit

Pako e Ringjalljes Ekonomike, e prezantuar me datë 30 qershor 2021 ka filluar prezantimin dhe operacionalizimin e masave gradualisht. Pra jo të gjithë masat që i përmban kjo pako janë të funksionalizuara në të njëjtën kohë. Sa i përket masës së parë të kësaj pako, e cila i përmban shtatë nënmasa, operacionalizimi i saj ka filluar me datë 29 korrik, kur edhe filloi zbatimi i nënmasës 1.2 Mbështetja për të punësuarit e formalizuar. Vënja në zbatim pasoi me datat 5 dhe 6 gusht kur u funksionalizuan nënmasat 1.3 Mbështetja e punësimit të grave dhe nënmasa 1.1 Rikthimi në punë i atyre që kanë humbur vendin e punës gjatë pandemisë. Këto tre nënmasa të lartpërmendura janë nën përgjegjësinë dhe zbatimin e Administratës Tatimore të Kosovës. Nënmasa 1.4 Skema e punësimit të garantuar për të rinjtë është në fazën e zhvillimit të platformës e cila do të mundësojë automatizimin e kësaj platforme.

Edhe masa 1.5 Trajnimi dhe punësimi në TI ka filluar operacionalizimin. Me datë 22 shtator 2021, Qeveria e Kosovës ka ndarë 2 milionë Euro për këtë masë.<sup>12</sup> Një milionë Euro do të alokohen për subvencionimin e bursave për vajzat në fushën e STEM-it (Shkencë, Teknologji, Inxhinieri, dhe Matematikë) dhe një milionë Euro për trajnimin e të rinjve maturantë në fushën e TI-së.

<sup>12</sup> Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Lajme, Qeveria ndanë 2 milionë euro për bursa në STEM dhe trajnime në TI, e qasshme në <https://mf.rks-gov.net/Page.aspx?id=1,2,1130>, (qasur në nëntor, 2021)

<b>Punëdhënësi</b>			<b>i punësuarit</b>	
<b>Masa</b>	<b>Kërkesa</b>	<b>Persona</b>	<b>Kërkesa</b>	<b>Persona</b>
<b>1.1</b>	<b>470</b>	<b>1,013</b>	<b>676</b>	<b>676</b>
<b>1.2</b>	<b>1,107</b>	<b>4,066</b>	<b>3,598</b>	<b>3,598</b>
<b>1.3</b>	<b>1,810</b>	<b>4,882</b>	<b>1,992</b>	<b>1,992</b>

Për këto tre nënmasa kanë qenë të ndara 25 milionë Euro. Përkatësisht masa 1.1 ka të alokuara 10 milionë Euro, masa 1.2 gjithashtu 10 milionë Euro, ndërsa masa 1.3 ka të alokuara 5 milionë Euro. Për këto masa kanë pasur mundësi aplikimi punëdhënësit dhe të punësuarit. Varësisht nga masa, punëdhënësi ka pasur këto përfitime:

1.1 – 3 muaj nga 50% të pagës bruto (maksimum 170 Euro)

1.2 – 12 muaj nga 10% të kontributit pensional (maksimum 100 Euro)

1.3 – 3 muaj nga 50% të pagës bruto (maksimum 170 Euro) dhe 9 muaj të tjere nga 10% të kontributit pensional (maksimum 100 Euro)

Ndërsa i punësuarit ka pasur këto përfitime:

1.1 – 3 muaj nga 100 Euro

1.2 – 3 muaj nga 50 Euro


1.3 – 3 muaj nga 50 Euro

Pasi që kjo masë tashmë është mbyllur për aplikime të reja, duke llogaritur maksimumin e përfitimit për secilin aplikues, shifra përfituese për të gjithë aplikuesit është 13,320,750.00 Euro. Andaj, nga shuma e ndarë për këto masa, shuma e cila do të ndahet për aplikuesit që kanë qenë të suksesshëm është 53,28%. Si arsye e mundshme e mos aplikimit mund të jenë procedurat aplikuese, informimi jo i duhur dhe afati i aplikimit.

Sa i përket nënmasave tjera të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, pra nënmasës 1.6 Mbështetja e punësimit të personave me nevoja të veçanta dhe 1.7 Skema e granteve për zanatet, nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës, përkatësisht Ministria e Financave, Punës dhe Transferëve nuk ka njoftim për operacionalizimin e tyre. Këto nënmasa të cilat për nga vlera, arrijnë shifrën prej 25 milionë Euro, janë të rëndësishme të veçantë. Andaj edhe funksionalizimi i tyre do të duhej të bëhej tashmë. Kategoritë që prekin nënmasat në fjalë janë mjaft të prekura nga pandemia COVID-19 dhe zbatimi në praktikë do të ishte një lehtësim për ta.

Masa	Niveli i zbatimit	Analizë
Rikthimi në punë i atyre që kanë humbur vendin e punës gjatë pandemisë	Zbatim i kufizuar	Masa është operacionalizuar dhe ka qenë e hapur për aplikime. Për këtë masë ka filluar pagesa për përfituesit.
Mbështetja për të punësuarit e formalizuar	Zbatim i pjesshëm	Masa është operacionalizuar dhe ka qenë e hapur për aplikime. Për këtë masë ka filluar pagesa për përfituesit.
Mbështetja e punësimit të grave	Zbatim i pjesshëm	Masa është operacionalizuar dhe ka qenë e hapur për aplikime. Për këtë masë ka filluar pagesa për përfituesit.
Skema e punësimit të garantuar për të rinjtë	Zbatim i pjesshëm	Masa është operacionalizuar dhe është në fazën e zhvillimit të platformës për zbatimin e kësaj mase.
Trajnimi dhe punësimi në TI	Zbatim i pjesshëm	Masa është operacionalizuar dhe deri më tani janë ndarë 2 milionë Euro.
Mbështetja e punësimit të personave me nevoja të veçanta	Pa zbatim	Masa nuk ka filluar ende zbatimin dhe rrjedhimisht nuk është operacionalizuar ende.
Skema e granteve për zanatet	Pa zbatim	Masa nuk ka filluar ende zbatimin dhe rrjedhimisht nuk është operacionalizuar ende.

### Shkalla e papunësisë





## Masa 2


# Ringjallja e Ekonomisë dhe Prodhimit

Ekonomia ishte ndër sektorët më të prekur nga kriza globale e shkaktuar nga pandemia për gjatë 20 muajve të fundit. Kjo pasi që u kufizua lëvizja e lirë, pati mbyllje të kufijve dhe u vështirësua mbarëvajtja e jetesës. Ekonomia e cila mbledh afër vetës të gjithë sektorët e tjerë, duhet të mbështetet në mënyrë që të tejkalohet dëmi i shkaktuar. Andaj në Pakon e Ringjalljes Ekonomike, masa e dytë e integruar është pikërisht për mbështetje të ekonomisë dhe prodhimit, e kjo masë ka gjithsej të ndara 108 milionë Euro. Kjo shumë parashihet të shpërndahet në gjashtë nënmasa, të cilat janë të listuara më poshtë:

1. Subvencionimi i kredive investive
2. Mbështetje bizneseve për qasje në financa
3. Investime në TI dhe Inovacion
4. Mbështetja e Eksportit
5. Ringjallja e fshatit përmes bujqësisë dhe agro-turizmit
6. Rikuperimi i hotelërisë dhe bizneseve të mbyllura

Ekonomia bashkëkohore është një urë lidhëse mes prodhuesit, importuesit, eksportuesit, shitësit dhe blerësit. Andaj si një zingjir edhe dëmi i shkaktuar paraqitet te secili pjesëmarrës i saj. Edhe po të mos detyroheshin mbylljet dhe masat tjera të cilat parandalojnë shpërndarjen e pandemisë, dëmet do të ishin të paevitueshme. Një ekonomi e dëmtuar tashmë lehtë evidentohet në Republikën e Kosovës, dhe ndihma përmes të cilës Qeveria e Kosovës po tenton të rimëkëmbë këtë sektor mund të mos jetë e mjaftueshme.

Për të adresuar ndikimet negative të pandemisë COVID-19, Qeveria e Kosovës ka implementuar edhe pako të tjera para Pakos së Ringjalljes Ekonomike. Qeveria e Kosovës fillimisht ka miratuar një pako emergjente në vlerë prej 179 milionë Euro, e cila ka pasur fokus kryesor Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme. Më vonë, përkatësisht gjatë muajit korrik 2020, Qeveria ka miratuar Programin e Rimëkëmbjes Ekonomike duke ndarë 365 milionë Euro për të përkrahur bizneset në krijimin dhe ruajtjen e vendeve të punës. Tashmë kemi edhe Pakon e Ringjalljes Ekonomike, me gjithsej 420 milionë Euro, e cila synon rikthimin në normalitet dhe zhvillimin e mëtutjeshëm ekonomik.



## Niveli i Zbatimit


Nga gjashtë nënmasat e masës së dytë, shumica e tyre nuk kanë filluar funksionalizimin. Nuk ka shpjegim nga Qeveria e Kosovës se pse nuk ka filluar me implementimin e këtyre nënmasave, ani pse sektori për të cilin janë të dedikuara këto masa është ndër më të prekurit. Vetëm nënmasa e parë, e quajtur Subvencionimi i kredive investive, ka filluar me zbatimin e pjesshëm ku parat e mbledhura nga Bonot e Diasporës, e që gjithsej janë 10.43 milionë Euro, janë alokuar për subvencionimin e kredive investuese të bizneseve prodhuese e përpunuese. Kjo masë ka për synim rritjen e investimeve të reja në zgjerimin e kapaciteteve të bizneseve, e cila rrjedhimisht ndikon edhe në rritjen e punësimit dhe eksportit.

Të gjitha nënmasat tjera të kësaj mase nuk janë funksionalizuar ose janë funksionalizuar në një masë shumë të vogël. Nënmasa 2.2 Mbështetje bizneseve për qasje në financa, në mbledhjen e datës 11 gusht 2021 të Qeverisë është mbështetur me 3 milionë Euro.<sup>13</sup> Vlera e nënmasave të cilat ende nuk kanë filluar të zbatohen është 78 milionë Euro. Një nivel i tillë i zbatimit është jo i kënaqshëm dhe kërkohet nga ana e Qeverisë së Kosovës që të operacionalizohen më shpejtë, në mënyrë që të përfitojnë kategoritë përfituese nga këto masa.

<sup>13</sup> Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Lajme, Qeveria e Kosovës ndau 30 milionë euro për zbatimin e katër masave të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, e qasshme në <https://mf.rks-gov.net/Page.aspx?id=1,2,1111>, (qasur në nëntor, 2021)

Masa	Niveli i zbatimit	Analizë
Subvencionimi i kredive investive	Zbatim i kufizuar	Masa është operacionalizuar dhe është hapur afati për aplikim për subvencionim.
Mbështetje bizneseve për qasje në financa	Zbatim i pjesshëm	Masa ka filluar të zbatohet dhe janë ndarë 3 milionë Euro për zbatim të plotë të saj.
Investime në TI dhe Inovacion	Pa zbatim	Masa ende nuk është operacionalizuar dhe nuk ka filluar të zbatohet.
Mbështetja e Eksportit	Pa zbatim	Masa ende nuk është operacionalizuar dhe nuk ka filluar të zbatohet.
Ringjallja e fshatit përmes bujqësisë dhe agro-turizmit	Pa zbatim	Masa ende nuk është operacionalizuar dhe nuk ka filluar të zbatohet.
Rikuperimi i hotelerisë dhe bizneseve të mbyllura	Pa zbatim	Masa ende nuk është operacionalizuar dhe nuk ka filluar të zbatohet.

Shkalla e papunësisë



## Masa 3

### Mbështetja për familjen

Periodha e pandemisë COVID-19 ka qenë dhe ende mbetet kohë shumë e vështirë për të gjithë shoqërinë. Shëndeti dhe mirëqenia sociale u vendosën para një rreziku i cili do të dëmtojë të gjithë vendet dhe qytetarët anë e mbanë botës. Edhe në vendin tonë pandemia COVID-19 solli pasoja të mëdha, në këto dy fusha. Vdekjet e shkaktuara si rrjedhojë e pandemisë dhe pasojat tjera shëndetësore dëmtuan familjet dhe shoqërinë në aspektin emocional, ekonomik dhe social. Pako e Ringjalljes Ekonomike, si masë të tretë të saj ka Mbështetjen për familjen, masë së cilës ia ka dedikuar gjithsej 50 milionë Euro. Kjo shumë parashihet të shpërndahet në gjashtë nënmasa, të cilat janë:

1. Mbështetja për familjet që kanë humbur kryefamiljarin
2. Mbështetja për pensionistët dhe familjet me asistencë sociale
3. Reformimi i Skemës së Asistencës Sociale
4. Kuponë ushqimi për familjet në nevojë
5. Pagesa për lehonat e papuna
6. Mbështetja e likuiditetit familjar

Pandemia COVID-19 ka treguar sesi dobësitë në sistemet shëndetësore mund të kenë implikime të thella për shëndetin, përparimin ekonomik, besimin në qeveri dhe kohezionin social. Prandaj, është thelbësore që sa i përket familjeve dhe qytetarëve më të rrezikuar nga infektimi, të krijohen mbështetje në aspektin ekonomik dhe social. Disa prej nënmasave të masës së tretë kanë filluar të zbatohen dhe një gjë e tillë ka qenë e mirëpritur nga e gjithë shoqëria.

#### Niveli i Zbatimit

Nënmasat e masës së tretë, të cilat prekin më së shumti kategoritë e shoqërisë, të cilët janë më të ndjeshme dhe të cilat kanë pasur dëme të mëdha nga pandemia COVID-19, kanë filluar të funksionalizohen. Nga gjithsej gjashtë nënmasa që i përfshin masa e tretë e Pakos së Ringjalljes Ekonomike, pesë prej tyre tashmë kanë filluar zbatimin. Ndër nënmasat të cilat janë në procesin e implementimit të tyre janë nënmasa 3.1 Mbështetja për familjet që kanë humbur kryefamiljarin, 3.2 Mbështetja për pensionistët dhe familjet me asistencë sociale, 3.4 Kuponë ushqimi për familjet në nevojë, 3.5 Pagesa për lehonat e papuna dhe 3.6 Mbështetja e likuiditetit familjar. Vetëm nënmasa 3.3 Reformimi i Skemës së Asistencës Sociale nuk ka filluar ende të zbatohet.

Nënmasa 3.1 ka filluar zbatimin me datë 28 shtator 2021, ku secilës familje e cila ka humbur familjarin si shkak i pandemisë COVID-19, do t'i subvencionohet shuma prej 1,500 Euro.<sup>14</sup> Një shumë e tillë tenton që sado pak të lehtësojë dëmet që janë paraqitur tek familjet e prekurra. Me datë 26 tetor është ekzekutuar pagesa për grupin e parë të Masës 3.1 për familjet që kanë humbur familjarin nga COVID-19, për rreth 500 familje përfituese. Data e aplikimit për këtë masë është e hapur deri më 30 nëntor 2021, në vegëzën <https://masa3-1.rks-gov.net/>.

Me datë 11 gusht 2021, në mbledhjen e Qeverisë së Kosovës u alokuan 17 milionë Euro për masën 3.2 Mbështetja për pensionistët dhe familjet me asistencë sociale.<sup>15</sup> Ndërsa, me datë 27 tetor 2021 u ndanë edhe 36 milionë Euro për zbatimin e kësaj mase.<sup>16</sup> Përmes këtyre mjeteve të ndara, synohet rritja e mirëqenies sociale dhe lehtësimi i dëmeve për këtë kategori. Vlen të theksohet se këto shtesa do të aplikohen deri në fundin e këtij viti fiskal.

Gjithashtu edhe masa 3.4, 3.5 dhe 3.6 kanë filluar zbatimin. Me datë 11 shtator 2021 është hapur aplikimi për masën 3.5 Pagesa për lehonat e papuna.<sup>17</sup> Ndërsa, me datë 1 tetor 2021 ka filluar edhe subvencionimi për masën 3.6 Mbështetja e likuiditetit familjar, ku përmes kësaj mase do të përfitojnë personat të cilët marrin kredi konsumuese deri në 10,000 Euro. Deri më tani është ekzekutuar pagesa e shtesave për fëmijë, për rreth 86 mijë përfitues, për muajin tetor.

Në kuadër të kësaj mase janë ndarë edhe përfitimet për shtesat për fëmijë. Përfitues janë të gjithë fëmijët që kanë lindur nga viti 2015 e tutje. Duke u bazuar në të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës, nga viti 2015 e deri në muajin gusht të vitit 2021, numri i lindjeve është 173,384 fëmijë. Deri më tani, 102 mijë është numri i përfituesve nga kjo masë apo 58,82%. Afati mbetet ende i hapur për aplikim dhe pagesat për muajt shtator dhe tetor janë realizuar.

<sup>14</sup> Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Lajme, Fillon mbështetja për familjet që kanë humbur familjarin nga COVID-19, e qasshme në <https://mf.rks-gov.net/Page.aspx?id=1,2,1131> , (qasur në nëntor, 2021)


<sup>15</sup> Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Lajme, Qeveria e Kosovës ndau 30 milionë euro për zbatimin e katër masave të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, e qasshme në <https://mf.rks-gov.net/Page.aspx?id=1,2,1111> , (qasur në nëntor, 2021)

<sup>16</sup> Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Lajme, Ndahen mbi 36 milionë euro për përfituesit e skemave sociale dhe pensionale, e qasshme në <https://mf.rks-gov.net/Page.aspx?id=1,2,1142> , (qasur në nëntor, 2021)

<sup>17</sup> Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Lajme, Fillon mbështetja për lehonat dhe skema për shtesat për fëmijë, e qasshme në <https://mf.rks-gov.net/Page.aspx?id=1,2,1123> , (qasur në nëntor, 2021)

Masa	Niveli i zbatimit	Analizë
Mbështetja për familjet që kanë humbur kryefamiljarin	Zbatim i pjesshëm	Masa është operacionalizuar dhe ka filluar të zbatohet. Tashmë është ekzekutuar pagesa për rreth 500 familje që kanë humbur familjarin si pasojë e pandemisë COVID-19.
Mbështetja për pensionistët dhe familjet me asistencë sociale	Zbatim i pjesshëm	Masa është operacionalizuar dhe ka filluar të zbatohet. Deri më tani janë ndarë 53 milionë Euro për këtë masë. Përfituesit e skemave pensionale në muajin nëntor do të përfitojnë nga 100 euro shtesë mbi pensionin e rregullt dhe shtesën aktuale. Në anën tjetër, përfituesit e skemave sociale në muajt nëntor dhe dhjetor do të përfitojnë dyfishin e pagesës së rregullt dhe shtesës aktuale.
Reformimi i Skemës së Asistencës Sociale	Pa zbatim	Masa ende nuk është operacionalizuar dhe nuk ka filluar të zbatohet.
Kuponë ushqimi për familjet në nevojë	Zbatim i plotë	Masa është operacionalizuar dhe tashmë është mbyllur afati për aplikim. Përmes saj është tentuar mbështetje për kuzhinat popullore për personat në nevojë. Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve Hekuran Murati ka nënshkruar marrëveshjet e mbështetjes financiare me përfaqësuesit e organizatave përfituese (14) me datë 9 nëntor 2021.
Pagesa për lehonat e papuna	Zbatim i pjesshëm	Masa është operacionalizuar dhe ka filluar edhe zbatimi i pagesave për përfituesit.
Mbështetja e likuiditetit familjar	Zbatim i kufizuar	Masa është operacionalizuar dhe mbështetja është ofruar për mbështetje për të mbuluar shpenzimet sezonale familjare, shpenzimet e shkollës, mbylljen e bilanceve të kredit kartelave

Niveli i zbatimit



## Masa 4

### Mbështetja për publiken

Mbështetja për publiken apo masa e katërt e Pakos së Ringjalljes Ekonomike është masa me shumën më të madhe të alokuar të parave. Me gjithsej 112 milionë Euro, të cilat janë të ndara në gjashtë nënmasa. Kjo masë tenton që të ndihmojë sektorët publik të prekur dhe dëmtuar nga pandemia COVID-19. Në pako është prezantuar që sektorët të cilët do të ndihmohen janë shëndetësia, arsimi, siguria, kultura dhe sporti, ndërrmarjet publike, si dhe do të ndihmohet mërgata. Gjashtë nënmasat e masës së katërt janë:

- Mbështetja për shëndetësinë
- Mbështetja për arsimin
- Mbështetja e Kulturës dhe Sportit
- Mbështetja e sigurisë
- Mbështetja e mërgatës
- Mbështetja e ndërmarrjeve publike

#### Niveli i Zbatimit


Me datë 11 gusht 2021, në mbledhjen e Qeverisë u ndan 5 milionë Euro për nënmasën e tretë të masës së katërt si dhe 5 milionë Euro të tjera u ndan për nënmasën e pestë të kësaj mase.<sup>18</sup> Përmes ndarjes së këtyre mjeteve u bë edhe alokimi i plotë i fondeve të parapara për këto dy nënmasa. Por edhe nënmasat tjera janë mbështetur deri më tani, ani pse jo të gjitha prej tyre.

Me datë 25 gusht 2021, në mbledhjen e Qeverisë u ndan 2.7 milionë Euro në kuadër të nënmasës së parë të masës së katërt. Këto mjete u ndan si mbështetje e stafit mjekësor në sektorin publik me pagë shtesë prej 10% të pagës së rregullt bruto, jo më pak se 60 Euro për muajt gusht, shtator dhe tetor të vitit 2021. Me këtë kemi një zbatim të pjesshëm të kësaj nënmasë, e cila gjithsej sipas Pakos së Ringjalljes Ekonomike, ka të ndara 53 milionë Euro.

<sup>18</sup> Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Lajme, Qeveria e Kosovës ndau 30 milionë euro për zbatimin e katër masave të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, e qasshme në <https://mf.rks-gov.net/Page.aspx?id=1,2,1111>, (qasur në nëntor, 2021)

Masa	Niveli i zbatimit	Analizë
Mbështetja për shëndetësinë	Zbatim i pjesshëm	Janë ndarë 2.7 milionë Euro për shtesat ndaj stafit mjekësor në sektorin publik
Mbështetja për arsimin	Pa zbatim	Masa ende nuk është operacionalizuar dhe nuk ka filluar të zbatohet.
Mbështetja e Kulturës dhe Sportit	Zbatim i plotë	Janë ndarë 5 milionë Euro për këtë masë si mbështetje ndaj aktiviteteve kulturore dhe sportive
Mbështetja e sigurisë	Pa zbatim	Masa ende nuk është operacionalizuar dhe nuk ka filluar të zbatohet.
Mbështetja e mërgatës	Zbatim i plotë	Janë ndarë 5 milionë Euro për këtë masë si mbështetje ndaj mërgatës.
Mbështetja e ndërmarrjeve publike	Pa zbatim	Masa ende nuk është operacionalizuar dhe nuk ka filluar të zbatohet.

Niveli i zbatimit





## Masa 5

# Investimi në infrastrukturë dhe ambient

Masa e pestë e Pakos së Ringjalljes Ekonomike mban në vete 100 milionë Euro, të cilat do të investohen në projekte që mbrojnë mjedisin dhe zhvillojnë infrastrukturën rrugore dhe hekurudhore. Sipas Qeverisë, është duke u negociuar me institucione financiare ndërkombëtare edhe për investime tjera në fushën e eficiencës dhe energjisë elektrike dhe gjithashtu është në hulumtim edhe për mundësi tjera financimi nga grantet dhe donatorët. Këto mjete janë të nevojshme dhe të domosdoshme për arritjen e caceve të përcaktuara sipas strategjive dhe projekteve të kaluara dhe të reja.

Ristrukturimi i efikasitetit të energjisë është një mënyrë shumë efektive për të ulur emetimet dhe për të kontribuar në objektivat evropiane, kombëtare dhe lokale të klimës. Andaj investimet nxisin ekonomitë lokale, duke stimuluar industrinë inovatore vendore, konstruktorët, prodhuesit dhe të tjerët që të sjellin projekte të reja në vendin tonë. Si një kapitull i ri i energjisë, burimet e ripërtrishme dhe investimet në këtë kategori të burimeve energjetike janë të domosdoshme. Mjetet e ndara në Pakon e Ringjalljes Ekonomike ende nuk kanë filluar të zbatohen në praktikë dhe duke e parë pikën në të cilën gjendet sektori energjetik, këto investime duhet të jenë të menjëhershme.

Investimi në infrastrukturën publike mund të përmirësojë cilësinë e jetës së një shteti, mjedisin dhe mundësitë. Kjo pasi që përmes përmirësimit të infrastrukturës, krijohen kushte për investime të reja nga investitorët e jashtëm, por edhe ata të brendshëm. Gjithashtu me krijimin e një infrastrukture të qëndrueshme, kontribuojmë në ambient dhe në mbrojtjen e mjedisit.

**Asnjë prej nënmasave të kësaj mase nuk ka filluar të zbatohet!**

# Përfundime

- Rivitalizimi i ekonomisë tashmë është duke ndodhur dhe po ndihmohet edhe përmes pakos së tanishme ekonomike. Përmes pakove të kaluara dhe pakos aktuale, sektorët ekonomik po ndihmohen në mënyrë që të u lehtësohet rimëkëmbja nga dëmet që pandemia COVID-19 ka shkaktuar. Edhe pse një gjë e tillë po ndodh me hapa jo shumë të shpejtë, shenjat janë pozitive që përmes lehtësimeve dhe ndihmave do të tejkalohen problemet e paraqitura tash e njëzet muaj.



- Ministria e Financave, Punës dhe Tranfereve ka filluar implementimin e Pakos së Ringjalljes Ekonomike. Pas prezantimit dhe miratimit të saj, implementimi ka filluar me operacionalizimin e masës 1.2, 1.3 dhe 1.1. Këto masa kanë qenë nën monitorimin e Administratës Tatimore të Kosovës. Ndërsa përpos këtyre masave edhe të tjera masa janë duke u zbatuar aktualisht, por jo të gjitha.
- Konsultime për formulimin e pakos janë mbajtur me disa prej akterëve institucional, por nuk janë mbajtur konsultime publike. Konsultimet publike me qytetarët kanë munguar, andaj niveli i transparencës së kësaj pako nuk është shumë i lartë. Gjithashtu, Pako e Ringjalljes Ekonomike do të kishte gjithëpërfshirje dhe adresim më të mirë të problemeve të shkaktuara nga pandemia COVID-19, nëse të gjitha grupet shoqërore do të dëgjoheshin.
- Një pjesë e masave të Pakos së Ringjalljes Ekonomike kanë filluar zbatimin, ndërsa shumë prej tyre ende nuk kanë filluar të zbatohen. Gjithsej janë 25 nënmasa të përmbledhura në 5 masa kryesore. Nga këto 25 nënmasa, 15 kanë filluar të zbatohen ndërsa pjesa tjetër ende nuk ka filluar zbatimin apo nuk është operacionalizuar. Zbatimi i të gjitha masave në një të ardhme të afërt do të ndikonte në përmirësimin e dëmeve dhe do të lehtësonte procesin e rimëkëmbjes ekonomike nga pandemia.
- Masa e pestë e Pakos së Ringjalljes Ekonomike ka rëndësi të madhe për zhvillimin ekonomik dhe sektorin energjetik të vendit tonë. Andaj, implementimi sa më i shpejtë dhe veçanërisht në efikasitet të energjisë dhe në projekte të reja të gjenerimit të energjisë elektrike përmes burimeve të ripërtrishme, përbën rëndësi primare për interesin publik. Përmes këtyre investimeve mund të rriten vendet e punës, të krijohet më shumë siguri energjetike dhe njëkohësisht të lehtësohet tranzicioni energjetik.
- Qeveria e Kosovës nuk është duke bërë kampanjë të shtuar vetëdijësimi rreth aplikimit dhe përfitimit nga masat e Pakos së Ringjalljes Ekonomike. Nuk ka shpërndarje të mjaftueshme të informatave tek qytetarët, andaj edhe numri i aplikimeve nuk është i duhuri deri më tani. Një fushatë promovimi dhe e ndarjes së informatave shitesë do të ndikonte në rritjen e aplikimeve dhe rrjedhimisht edhe të përfituesve.



“Ky projekt mbështetet nga Balkan Trust for Democracy (BTD) një projekt i Fondit Gjerman Marshall të SHBA-ve dhe popullit amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe zbatohet nga Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura nuk pasqyrojnë pikëpamjet dhe opinionet e BTD, GMF, USAID ose Qeverisë së SHBA-së.”